

VENDIM
Nr. 708, datë 26.11.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS DOMENIKANE, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR SHTETASIT,
MBAJTËS TË PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Dominikane, për heqjen e vizave për shtetasit, mbajtës të pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe zyrtare, nënshkruar në Nju-Jork, më 25.9.2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS DOMENIKANE PËR HEQJEN E VIZAVE PËR
SHTETASIT MBAJTËS TË PASAPORTAVE DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE
ZYRTARE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Domenikane, në vijim të referuara në veçanti si “Pala Kontraktuese” dhe së bashku të referuara si “Palët Kontraktuese”,

frymëzuar nga dëshira për të forcuar marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin e ndërsjellë të bazuar në besim dhe solidaritet;

të nxitur nga objektivi i përbashkët për lehtësimin e udhëtimeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Domenikane për shtetasit që kanë pasaporta diplomatike, të shërbimit dhe zyrtare;

të vetëdijshëm se vendosja e kërkesave dhe kushteve për jo shtetasit për të hyrë, për të qëndruar ose për të dalë nga territori i Shteteve Palë është prerogativë e tyre ekskluzive, kanë rënë dakord, si më poshtë:

Neni 1

Personeli diplomatik dhe konsullor

1. Shtetasit e secilës prej Palëve Kontraktuese, që mbajnë pasaportë diplomatike, të shërbimit ose zyrtare, të caktuar nga qeveritë e tyre përkatëse për të punuar në misionet e tyre diplomatike, zyrat konsullore dhe organizatat ndërkombëtare, të vendosura në shtetin e Palës tjetër Kontraktuese, mund të hyjnë, kalojnë tranzit dhe qëndrojnë atje gjatë periudhës së funksioneve të tyre pa vizë.

2. Dispozitat e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni zbatohen edhe për të afërmit e

zyrtarëve të përmendur, të cilët kanë pasaportë të vlefshme diplomatike, të shërbimit ose zyrtare.

Neni 2

Qëllimi i udhëtimit

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe zyrtare të vlefshme, që nuk janë caktuar në misionin diplomatik ose konsullor, ose në një organizatë ndërkombëtare të Palës tjetër Kontraktuese, nuk do të kërkojnë vizë për të hyrë, kaluar tranzit ose qëndruar në territorin e saj, jo më shumë se 90 (nëntëdhjetë) në çdo periudhë 180- ditore.

2. Në varësi të paragrafit 1, shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike të shërbimit ose zyrtare, të lëshuara nga secila Palë Kontraktuese, të cilët me qëllim planifikojnë të studiojnë në institucione arsimore me një program kurrikular që tejkalon 90 (nëntëdhjetë) ditë brenda një periudhe 180-ditore nga data e hyrjes, ose për të marrë pjesë në ndonjë hetim tjetër akademik ose profesional, si dhe për të dhënë këshillim profesional, konsulencë, ose për të ofruar ndonjë shërbim tjetër profesional subjekteve private, ose organizatave ndërkombëtare, ose në vend të kësaj për të marrë pjesë në aktivitete joqeveritare me rrogë dhe ligjore, të respektuara nga ligjet e kësaj Pale, do të marrë vizën përkatëse përpara se të hyjë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Respektimi i ligjeve kombëtare

1. Për të përfituar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, shtetasit e secilit Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, të shërbimit ose zyrtare, të lëshuara nga secila Palë Kontraktuese, do të hyjnë përmes pikës kufitare të autorizuar ligjërisht të hapur për trafikun ndërkombëtar të pasagjerëve.

2. Shtetasit e secilit shtet Palë Kontraktuese, përfitues të kësaj Marrëveshjeje janë të detyruar të respektojnë ligjet dhe rregulloret e Palës tjetër Kontraktuese, pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre të dhëna nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, si dhe çdo instrument tjetër përkatës ndërkombëtar dhe normat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të kufizojnë të drejtën e asnjërës Palë Kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose tërheqjen e autorizimit për të qëndruar, ose për të shkurtuar qëndrimin e synuar, për shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike të shërbimit dhe zyrtare, në përputhje me ligjet kombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi, për shkak të mungesës së kushteve të pranimit ose përjashtimit, si dhe atyre që mund të mos respektojnë dispozitat ligjore të vendosura nga secila Palë Kontraktuese në lidhje me pranimin e të huajve në territorin e tyre, duke mos lejuar që kjo e drejtë të bëhet një rregull ose thjesht të përgjithësojë zbatimin e tij.

Neni 4

Ligjet dhe dokumentet përkatëse

1. Palët Kontraktuese do të përfundojnë, përmes kanaleve diplomatike, shkëmbimin e modeleve të pasaportave të tyre diplomatike, të shërbimit ose zyrtare, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast të paraqitjes nga secila Palë Kontraktuese të ndonjë modifikimi në pasaportat e saj të vlefshme diplomatike, të shërbimit dhe zyrtare, do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese,

nëpërmjet rrugëve diplomatike, duke bashkangjitur një ekzemplar të pasaportës së re ose të modifikuar, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë para prezantimit të saj.

3. Secila Palë Kontraktuese angazhohet të informojë Palën tjetër Kontraktuese, sa më parë, nëpërmjet rrugëve diplomatike, për modifikimet e bëra në ligjet dhe në rregulloret e tyre, në lidhje me hyrjen, kalimin ose qëndrimin e të huajve në territorin e saj.

Neni 5

Pezullim i marrëveshjes

1. Secila Palë Kontraktuese do të ketë të drejtën të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për arsye të sigurisë kombëtare, rendit ose shëndetit publik.

2. Pala Kontraktuese që miraton masën e pezullimit të Marrëveshjes do të njoftojë Palën tjetër, si dhe do të informojë kur pushojnë motivet e pezullimit, me qëllim tërheqjen e masës së pezullimit.

Neni 6

Kushtet e përgjegjësisë

1. Kjo Marrëveshje nuk do të ndikojë në detyrimet që kanë epërsi ndërmjet Palëve Kontraktuese, që rezultojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, në veçanti Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore, si dhe çdo instrument tjetër përkatës ndërkombëtar dhe normat e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 7

Hyrja në fuqi, vlefshmëria dhe ndryshimet

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë (30) pas datës së njoftimit me shkrim të kësaj të fundit nga Palët Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, ku njoftohet se janë përmbushur kërkesat e brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve Kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar. Nëse njëra Palë Kontraktuese dëshiron të përfundojë këtë Marrëveshje, ajo do të njoftojë Palën tjetër Kontraktuese me shkrim përmes kanaleve diplomatike dhe Marrëveshja do të pushojë së qeni efektive në ditën e nëntëdhjetë (90) pas datës së njoftimit.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët Kontraktuese do të konsultohen me njëra-tjetrën për vështirësitë e mundshme që dalin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultime ose negociata, nëpërmjet rrugëve diplomatike, ndërmjet Palëve Kontraktuese.

3. Çdo interpretim i rënë dakord ose kriter zbatimi, si rezultat i konsultimeve ose i negociatave ndërmjet Palëve Kontraktuese, në bazë të praktikës aktuale ose procedurave formale, nuk do të nënkuptojë asnjë modifikim ose ndryshim në këtë Marrëveshje.

Bërë në Nju-Jork, më 25.9.2025, në dublikatë, në gjuhët shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht

do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Elisa Spiropali

Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS DOMENIKANE

Roberto Álvarez

Ministër i Punëve të Jashtme